



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve”

PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.02.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Jorida Tabaku – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Njoftim i përfundimit të hetimit.

Marrin pjesë:

Jorida Tabaku, Ermonela Valikaj (Felaj), Antoneta Dhima, Anila Denaj, Arben Pëllumbi, Fadil Nasufi, Eduard Shalsi, Besion Ajazi, Etjen Xhafaj, Dhurata Tyli (Çupi), Belind Këlliçi, Lefter Gështenja, Luçiano Boçi, Helidon Bushati, Ina Zhupa dhe Denis Deliu.

HAPET MBLEDHJA

Jorida Tabaku – Të nderuar kolegë, ju uroj mirëmëngjesi në fillimin e mbledhjes së fundit të komisionit hetimor për inceneratorët. Sot në datën 25 shkurt është mbledhja e fundit, e cila shënon edhe fundin e hetimeve.

Dëshira e përfaqësuesve të Partisë Demokratike ka qenë që ky komision t'i vazhdonte hetimet, të kishim më shumë kohë në dispozicion, por, fatkeqësisht, ne nuk arritëm dot të gjejmë dakordësi për këtë çështje.

Java e fundit ishte me shumë dëshmitarë, e ngjeshur me shumë informacione, njëkohësisht me dosje voluminoze, të cilat i kanë ardhur këtij komisioni; besoj se janë lexuar nga të gjitha palët. Unë dje bëra një thirrje të fundit për zotin Gledis Nano, drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, për të cilin ne jemi ende në pritje për të marrë të dhënat TIMS të personave të përfshirë në këtë hetim, të cilat i kemi kërkuar që në datën 4 shkurt; për zonjën Brunilda Lilo, avokate e Përgjithshme e Avokaturës së Shtetit; për zotin Erjon Veliaj, i cili nuk ka sjellë procedurat e komunikimit ndërmjet institucioneve për sa i përket vendimmarrjes për inceneratorin e Tiranës, megjithëse ne patëm një dëshmi shumë të rëndësishme dhe ai pjesën më të madhe të elementeve, sigurisht, i pranoi këtu; për bankën e nivelit të dytë, *Credins* për të dhënat e kompanisë dhe për zotin Petrit Vasili, për të cilin jemi ende në pritje.

Ndërkohë, në mbledhjen e ditës së martë, sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrit së premtoi përpara këtij komisioni që brenda fundit të ditës së martë ose përpara dëshmisë së Kryeministrit, ditën e mërkurë, do të sillte procesverbalet e mbledhjes së Këshillit të Ministrave, ku ishin diskutuar kontratat koncesionare, do të sillte relacionin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 907, që është baza, e cila i hap rrugë financimit të inceneratorit të Elbasanit, por, njëkohësisht, edhe kërkesën e ministrit dhe autoritetit kontraktues për këtë vendim të Këshillit të Ministrave, por, njëkohësisht, do të interesohej për raportin e inspektimit financiar, për të cilin, siç dukej, nuk kishte dijeni askush. Këto elemente nuk kanë ardhur akoma në komisionin hetimor dhe unë pres brenda ditës së sotme që ne t'i administrojmë këto dokumente.

Ndërkohë, në mbledhjen e fundit të komisionit hetimor unë dua të bëj shkurt një përmbledhje të asaj që ka ndodhur në katër muajt e fundit dhe jo vetëm.

Çështja e inceneratorëve është ngritur si një aferë korruptive e supozuar nga Partia Demokratike në vitin 2016, pas denoncimeve të shumta të kontratave koncesionare të Elbasanit, e

cila kishte filluar, nga disa medie kryesisht sporadike, të vogla, pa peshë, ku kryesonte zoti Artan Rama me denoncimet e tij e më pas nga mediet “Monitor” dhe “BIRN”, ku kjo çështje filloi të bëhej publike. Denoncimi i parë për kontratën e Elbasanit nxori në dritë procedurat korruptive të kësaj kontrate, të cilat ne i diskutuam gjatë në këtë komision. Në vitin 2017 denoncimet vazhduan sepse, përveç kontratës së Elbasanit, vazhdonte njëkohësisht procesi për kontratën e impiantit të trajtimit të mbetjeve në Fier, ndërkohë që nisi edhe procedura e impiantit të trajtimit të mbetjeve në qytetin e Tiranës.

Në shkurt të vitit 2018 Partia Demokratike ka bërë një interpelancë me ish-ministrin Gjijnuri për këtë çështje. Të gjithë ju kujtohet sesi i gjithë parlamenti u ngrit në këmbë për t’i mbrojtur këto tri kontrata koncesionare me vlerë 430 milionë euro. Të tria kontratat koncesionare, duke përfshirë edhe atë të Tiranës, që nga formula, mënyra e hartimit të kontratës, por edhe zbatimi është më korruptiv, përbëjnë atë që, besoj për të gjithë qytetarët, gjatë këtyre tre muajve është bërë e qartë si afëra më korruptive e firmosur nga qeveria “Rama” gjatë 8 vjetëve të fundit.

Partia Demokratike në mënyrë konstante, pothuajse të përditshme, ka denoncuar pagesat që u shkonin këtyre kontratave, personat e përfshirë në këto kontrata.

Media ka ndihmuar për të zbuluar lidhjet e ministrave me personat, tri kompanitë, të cilat kanë marrë tri kontrata abuzive pa pasur asnjë ditë eksperiencë në fushën e trajtimit të mbetjeve; tri kompani, të cilat nuk kishin kapitalin për t’i zbatuar këto projekte, por menjëherë morën kredi bankare për t’i zbatuar këto projekte, por, nga ana tjetër, ngritën në këmbë një qeveri të tërë, duke krijuar procedurën ekstraligjore më korruptive të njohur ndonjëherë në Republikën e Shqipërisë.

Këtu kemi parë që të gjithë se si dëshmitarët një nga një kanë dhënë dëshminë e tyre dhe pjesa më e madhe e tyre kanë treguar, të paktën deri në nivelin politik, përfshirjen e tyre, faktin se askush nuk mban mend se si këto tri kontrata janë hartuar dhe janë zbatuar, se si askush nuk mban përgjegjësi për kontrollin financiar, auditin e këtyre kontratave, se si të gjithë kanë harruar, nuk dinë, nuk kanë parë, nuk mbajnë mend se çfarë ka ndodhur gjatë procesit të hartimit dhe zbatimit të këtyre kontratave, por më e rëndësishmja gjatë këtyre tre muajve, sidomos javën e fundit ne kemi parë mbrojtjen politike që u është bërë tri kontratave koncesionare me vlerë 430 milionë euro, e cila kulmoi ditën e mërkurë me Kryeministrin e vendit, zotin Edi Rama, dëshmitarin e fundit.

Unë besoj se në sytë e të gjithë shqiptarëve sot është e qartë se çfarë ka ndodhur. Në sytë e të gjithë shqiptarëve sot të gjithë e kanë të qartë që mbrojtja politike e dhënë, justifikimet, shfajësimet, mënyra se si është proceduar, lidhja e këtyre kontratave, njohjet me ministrat,

kontratat shtesë, që kanë marrë këto kompani, favoret që kanë marrë këta persona dhe fakti që sot këta tre persona janë në kërkim, tregojnë lidhjen e drejtpërdrejt, implikimin e shtetit dhe mbështetjen e shtetit. Nuk ndodh, siç tha Edi Rama, ai, i cili ndjek punët nga mëngjesi në mëngjesin tjetër, ditë e natë, që t'i shpëtojë gjë atij. Nuk ndodh kurrë në Republikën e Shqipërisë që të firmoset diçka, pa e ditur stafi i tyre, pa e analizuar stafi i tyre dhe pa ia çuar në tavolinë stafi. Nuk ndodh në Republikën e Shqipërisë që askush të mos ketë parë, të mos ketë dëgjuar dhe të mos dijë se çfarë ndodh.

Ne këtu morëm dëshmi shumë të rëndësishme dhe unë dua të veçoj atë të kryetarit të Bashkisë së Tiranës. Zoti Erion Veliaj këtu në betim tha se ka marrë një angazhim, pa pasur një vendim të këshillit bashkiak. Ka nënshkruar një kontratë me pjesën takuese të Bashkisë së Tiranës 91 milionë, pa pasur një vendim të këshillit bashkiak dhe kjo është shkelja më e rëndë, arroganca më e rëndë që i është bërë ndonjëherë pushtetit lokal në këto vite. Ashtu siç tha edhe vetë Kryeministri i vendit, kam qenë kryetar bashkie tha dhe se sa herë lindte nevoja shkoja në këshill bashkiak, por me këtë arrogancë në 30 vjet pushtet lokal ka arritur vetëm Erjon Veliaj, të shpërfillë këshillin bashkiak, të shkelë ligjin, të injorojë institucionet dhe të marrë një përgjegjësi financiare prej 91 milionë eurosh. Ndërkohë që kryetari i bashkisë këtu pranoi edhe një monopol, një koncesion 45 milionë euro, që i është dhënë për dherat, koncesionarit të Tiranës.

Ne nuk arritëm dot të marrim dëshminë e rëndësishme të zoti Alqi Bllako, sepse ai erdhi të dëshmonte, por, sigurisht, preferoi të mos përgjigjej për të mos cenuar personin e tij nën hetim, që organi i akuzës ka hapur, por zoti Bllako në gjykimin tonë është një person i përfshirë në dhënien e kësaj kontrate koncesionare me kryetarin e Bashkisë së Tiranës, por, njëkohësisht, në mbështetjen që i është dhënë kësaj firme koncesionarit të Tiranës për të marrë, njëkohësisht, edhe projektin e Porto-Romanos, dokumente, të cilat ne ia treguam kryetares së Bashkisë, zonjës Emiriana Sako, e cila u largua me arrogancë nga ky komision.

Unë besoj që ky komision ka pasur shumë pengesa. Ka pasur pengesat e mossjelljes së materialeve dhe dokumenteve; ka pasur pengesat e moslënies së dëshmitarëve për të ardhur deri këtu; pengesat e mosdërgimit edhe të shkresave, sepse shumë shkresa janë refuzuar për t'u dërguar; pengesa të gjata procedurale edhe gjatë dëshmive; pengesa që i kemi hasur deri ditën e fundit, por unë nuk besoj se opozitës dhe Partisë Demokratike i ka mbetur diçka për të bërë në këtë komision, sepse ka bërë maksimumin. Për këtë arsye, dua të falënderoj kolegët për punën, për angazhimin, për vigjilencën, për durimin edhe për faktin se u bëmë ne tabelë qitje, ndërkohë që

duhej të ishte e gjithë qeveria tabelë qitje. Kemi ruajtur etikën, kemi ruajtur komunikimin dhe asnjë rast nuk besoj se kjo është ceduar.

Shqetësimi kryesor, që kam ngritur në këtë komision nga dita e parë, lidhej me procedurat. Me procedurat, për të cilat ne sot kemi një pamje të qartë, kemi dokumentet, kemi dosjet dhe e dimë që ishin procedura korruptive, është e provuar dhe e faktuar, pavarësisht se shumë dokumente shtetërore nuk na janë vënë në dispozicion. Ashtu siç e kam thënë dhe e them, e përsëris që ka pasur zyrtarë të guximshëm të shtetit shqiptar, të cilët na i kanë sjellë këto informacione. Ashtu siç kemi pasur zyrtarë të përgjegjshëm të shtetit shqiptar, të cilët na kanë sjellë informacione edhe për kontrata, leje, favore, koncesione të tjera të këtyre tri kompanive.

Unë besoj se, në përfundim të këtij hetimi, ky komision hetimor, pavarësisht vështirësive, pengesave, sulmeve, pavarësisht çdo gjëje që ka ndodhur, ka arritur të bëjë maksimumin: i ka kthyer parlamentit rëndësinë e komisioneve hetimore; i ka kthyer parlamentit përgjegjësinë e tij me rolin e kontrollit dhe të monitorimit; i ka kthyer parlamentit llogaridhënien, por ajo, që është më e rëndësishmja, u ka dhënë qytetarëve transparencën për 430 milionë euro.

Sot nuk ka të madh e të vogël në Republikën e Shqipërisë që nuk e di që Edi Rama me Ëngjëll Agaçin kanë bërë 17 procedura brenda ditës për të dhënë kontratën e koncesionit të Elbasanit, ndërkohë që janë dhënë tri koncesione me 460 milionë euro. Sot nuk ka shqiptar që nuk e ka kuptuar që të gjithë njerëzit politikë, që erdhën në këtë komision, kishin vetëm një qëllim: të shpëtonin veten dhe të mos përfshinin veten. Nuk ia arritën dot. Ishte shumë e vështirë ta bëjë këtë, krahas provave dhe fakteve.

Ndjej një keqardhje të vogël, sepse, ndoshta, nuk arritëm t'i shfaqnim të gjitha provat dhe dokumentet që kemi pasur këtu, për arsye se disa nga dëshmitarët nuk dëshmuan, për shembull, zoti Alqi Bllako, anëtarët e komisionit të koncesionit, por janë të gjitha dokumente që do të jenë pjesë e raportit final, por edhe të dosjes dhe informacioneve që ne do t'i dërgojmë organit të akuzës. Unë besoj se në fund të këtij komision hetimor arritëm të tregojmë diçka: mbrojtja politike që ofroi qeveria, mbrojtja politike që ofroi kushdo, që ishte i përfshirë në këtë proces, mbrojtja politike, që u është bërë tri kompanive dhe pronarëve të kompanive që sot janë persona në kërkim, është asgjë kur ofrohet transparenca dhe llogaridhënia për publikun.

I falënderoj të gjithë qytetarët, që e kanë ndjekur me shumë interes komisionin hetimor, të cilët kanë bërë pyetje pa fund, të cilët na kanë dhënë informacione pafund, të cilat, ndoshta, nuk kemi arritur t'i transmetojmë të gjitha, por do të jenë pjesë e dosjes hetimore edhe këto. Ajo që

është më e rëndësishmja, falënderoj çdo punonjës përgjegjës të administratës publike që ka refuzuar të firmosë. Më lejoni të them se kanë qenë shumë të tillë që nuk kanë firmosur, që janë larguar, që kanë dhënë dorëheqjen nga komisioni i koncesionit, që kanë refuzuar të firmosin vendime korruptive dhe qeveria është detyruar të ndryshojë rrugë dhe të marrë vendime të tjera, të ndryshojë formën dhe mënyrën e këtyre koncesioneve.

Sot në fund të ditës, pasi këto koncesione kanë filluar të zbatohen në mënyrë abuzive, pasi 430 milionë euro janë tenderuar, koncensionuar dhe janë dhënë nga shteti shqiptar, së fundi inceneratorët nuk ekzistojnë. Ne e pamë me sytë tanë dhe e vërtetuar që, pas të gjitha këtyre procedurave korruptive, kësaj mbrojtjeje politike, këtyre sulmeve që u bëhen anëtarëve të komisionit hetimor, veçanërisht opozitës për guximin që kanë treguar për të folur me fakte, me prova dhe me argumente, por, njëkohësisht, zbatimit të kësaj kontrate në mënyrë abuzive, pagesave të jashtëzakonshme abuzive që ka pasur kjo kontratë, ne pamë që nuk ka incenerim, që inceneratorët e Tiranës, Elbasanit dhe Fierit nuk punojnë, që nuk justifikon asgjë, as foto me ngjyra, as bojë, asgjë nuk e justifikon vjedhjen, sepse qëllimi i ligjit, pavarësisht asaj që duan të mbulojnë, është një dhe vetëm një: zbatimi i ligjit. Qëllimi i këtij komisioni hetimor ka qenë, dhe ia ka dalë me shumë maturi dhe me shumë guxim të tregojë që këto tri afera korruptive, këto tri kontrata koncensionare prej 430 milionë eurosh sot kanë përfshirë nga punonjësi më i thjeshtë, që ka firmosur, deri te Kryeministri i vendit.

Seanca e ditës së mërkurë në shumë aspekte ishte ndriçuese për qytetarët, sepse, kushdo që e pyeste Kryeministrin, ai e sulmonte.

Dua t'u kërkoj ndjesë zonjave në këtë komision, edhe në emrin tim si kryetare e komisionit që, ndoshta, nuk kam bërë maksimumin për ta ndaluar Kryeministrin e vendit që të sulmonte anëtarët e këtij komisioni, por dua t'i falënderoj që i patën guximin t'ia thonë të vërtetën në sy Kryeministrit të vendit dhe kjo nuk është pak; ti thuash atij, që ka shkelur ligjin, ka bërë korrupsionin e ka abuzuar me 430 milionë euro, që je personi përgjegjës, sigurisht që nuk është pak.

Ka shumë njerëz, shumë qytetarë dhe shumë politikanë që thonë sikur të ishim ne në komisionin hetimor; kushdo do të kishtë bërë punën e vet, kushdo do të kishte mënyrën e vet. Unë jam e sigurt që opozita ka bërë maksimumin, dha maksimumin, zbuloi një nga aferat më të mëdha, që jam e sigurt që nuk ka filluar dhe nuk mbaron me Lefter Kokën. Lefter Koka është vetëm një: mban përgjegjësin e tij individuale.

Sot kushdo, që ka firmosur në këtë proces, çdo ministër që është përfshirë, çdo ministër që ka dhënë firmën, çdo ministër që ka dështuar të kontrollojë, çdo ministër që ka dështuar të zbatojë ligjin, që ka dhënë para dhe që po vazhdon të japë para për tre kriminelë në kërkim, çdo ministër këtu është përgjegjës. Ne në raportin përfundimtar do t'u tregojmë shqiptarëve çdo provë, çdo fakt dhe çdo argument që kemi mbledhur.

Sot kemi disa vendime për të njoftuar, përveç përfundimit të hetimit. Njoftojmë që në datën 7 mars ky komision do të sjellë raportin përfundimtar. Raporti përfundimtar, ashtu siç e përcakton edhe ligji për komisionet hetimore, duhet të jetë i përbashkët dhe të miratohet bashkërisht në këtë komision. Unë nuk do ta paragjykoj që ne do të kemi dy raporte të ndara, por jam e sigurt që ato mendime, të cilat ne ndajmë, nuk do të konvergojnë në një raport, për faktin se kurrë nuk kemi për t'i dhënë dot mbrojtje politike tre kriminelëve që sot janë në kërkim dhe marrin fonde nga buxheti i shteti edhe ndërkohë që flasim.

Nuk e di nëse ka nga kolegët ndonjë shqetësim, ose ndonjë çështje për të ngritur.

Urdhëroni, zonja Felaj!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, sipas planit hetimor që ne e kemi miratuar në datën 8 shkurt, të cilin e kemi realizuar, duhej që, sipas nenit 19 të ligjit për komisionet hetimore, por edhe sipas parashikimeve që përmban rregullorja e këtij komisioni, e miratuar me konsensus të plotë, t'i përfundonin hetimet konform të gjitha pikave të planit hetimor të miratuara në këtë komision.

Për vëmendjen e publikut dua të sjell edhe një herë, pra të kujtoj që pikat e atij e planit hetimor përqendroheshin: në mbledhjen e të dhënave, gjë e cila u krye në fazën e parë të këtij hetimi; në konstatimin e vendit, ku sot ngrihen dhe funksionojnë impiantet e trajtimit të mbetjeve, pra impianti i trajtimit të mbetjeve në Fier, në Elbasan dhe në Tiranë dhe pika e fundit e atij plani hetimor ishte ajo që, në fakt, ne e kryem në pothuaj dy javë të plota pune, pyetja e dëshmitarëve. Meqenëse të gjitha këto momente të planit hetimor, që ne kemi përmbushur, janë të përmbushura, do të thotë se sot vendimi, që duhet të merrte ky komision, ishte të përfundonte hetimet. Në fakt, këtë do të bëjë sot ky komision, sidoqoftë nuk kisha ndonjë surprizë edhe nga fakti që, edhe pse do të ishte një seancë shumë e shkurtër që të konfirmonte mbylljen e hetimeve, sidoqoftë do të bëhej një përmbledhje e të gjithës. Shpresoj që ai të mos jetë raporti përfundimtar dhe, në fakt, nuk do ta konsideroja raport përfundimtar për të vetmen arsye, sepse pastaj publiku do të përballej me atë që, ja, maxhoranca iu fsheh edhe raportit. Sigurisht, do të kemi raport; do të kemi raport për të gjitha

ato që u panë, për të gjitha ato që u dëgjuan dhe për të gjitha ato që u konstatuan në vend të një raporti, i cili do të përmbajë në vetvete një analizë të plotë, shteruese të sjelljes së organeve shtetërore në këtë temë.

Edhe një herë ju kujtoj se ky komision, për fat të keq, nuk arriti të ishte në performancën e plotë të një komisioni hetimor parlamentar, sepse për asnjë moment nuk e ndau një hetim parlamentar nga një hetim penal. Është zhgënjyese, sepse ne përfaqësojmë pushtetin ligjvënës dhe, nëse nuk e respektojmë ne parimin bazë të demokracisë, parimin e ndarjes së pushteteve, atëherë nuk e di kush tjetër duhet ta respektojë dhe kush tjetër duhet të kuptojë se sa fort duhet mbrojtur ky parim që me ekzistencën e tij, në fakt, siguron edhe demokracinë në vetvete. Kjo nuk u respektua për asnjë rast dhe për asnjë mbledhje edhe gjatë ditës së sotme, edhe tani kur jemi duke folur, kur duhej të flitej pikërisht për përfundimin e hetimit, për konstatimin e përmbushjes së të gjitha pikave të planit hetimor, por sërish u shfrytëzua mikrofoni për të përsëritur edhe një herë akuza, që unë që nga dita e parë e mbledhjes së këtij komisioni së bashku me kolegët e mi përfaqësues të maxhorancës në këtë komision i kemi konsideruar si akuza të ngritura sipas parimit: “Ta bëjmë sa më të madhe gënjeshtren që të kemi shans të besohet sado pak.”. Besoj se e kujtoni që ky komision nisi me pohimet e tipit “Impiantet janë fantazma; impiantet nuk ekzistojnë”, por impiantet ekzistojnë dhe sot qytetarët e Tiranës, qytetarët e Bashkisë së Durrësit, qytetarët e Bashkisë së Kavajës, qytetarët e Bashkisë së Fierit, qytetarët e Bashkisë së Lushnjës, qytetarët e Bashkisë së Roskovecit, qytetarët e Bashkisë së Patosit, qytetarët e Bashkisë së Elbasanit, qytetarët e Bashkisë së Cërrikut dhe qytetarët e Bashkisë së Përrenjasit duhet të jenë të sigurt se fushat, ku dikur depozitoheshin mbetjet që ishin shndërruar në fusha që edhe përshkrimi të Dantes, në fakt, ia kalojnë për ferrin, sot nuk ekzistojnë më. Mbetjet e qytetarëve të këtyre qyteteve që unë përmenda, sot trajtohen në këto impiante. Natyrisht, çdo gjë, që do të konsiderohet se është mbetje e ngurtë dhe, si e tillë, e papërdorshme, e pariciklueshme, do t’i nënshtrohet procesit të incenerimit. Sigurisht, kjo është një temë tjetër, nuk është rasti sot për të ndarë opinionet nëse duhet kjo apo duhet ajo, por një gjë të jetë e qartë: trajtimi i mbetjeve nuk është një recetë gatimi që të përtpet kaq lehtë dhe të zbatohet kaq lehtë, sepse çdo vend ka specifikat dhe karakteristikat e tij. E rëndësishme është që ne t’i përmbahemi asaj strategjie, e cila siguron të ketë një planifikim të qartë se si trajtohen mbetjet dhe më tej akoma kjo strategji të shoqërohet me veprime po aq të qarta që në fund të ditës sigurojnë edukimin e publikut, në raport me sjelljen e tyre ndaj mjedisit. Kjo është një sfidë për të gjithë; nuk është një sfidë për anëtarët e këtij komisioni, nuk është një sfidë

për aktorët e vijës së parë, që duhet të merren me luftën kundër të gjithë atyre që e impaktojnë situatën mjedisore dhe e rendojnë situatën mjedisore, por është një luftë e të gjithëve ne, që, sigurisht, na takon për jetën dhe shëndetin tonë, për jetën dhe shëndetin e brezave, të cilat do të vijnë, të sigurojmë një mjedis sa më të pastër.

Kjo betejë, tashmë, i ka hedhur themelet e para të saj, përkundrajt rezultateve të mëparshme që tregonin për mosveprim, që tregonin për një shpërfillje totale të situatës të mbetjeve në vend. Situata sot është qartësisht e dukshme, e prekshme, sepse malet shkumbuese të plehrave janë një realitet, i cili nuk i takon më vendit tonë dhe nuk i takon më Shqipërisë. Vulat e turpit, që na lanë dikur qeverisjet e mëparshme, nuk janë më të tilla për Shqipërinë.

Ajo që dua të them, në përfundim të fjalës së këtij komisioni hetimor, është pikërisht kjo: ne do të sigurohemi edhe nëpërmjet paraqitjes së raportit që në të ardhmen komisionet hetimore, parlamenti të ruajë rolin që i takon.

Dua të jem edhe një herë e qartë që ky komision hetimor tregoi për tolerancën nga ana e maxhorancës. Në fakt, maxhorancës i takon të jetë tolerante në një demokraci. Ky komision ishte ngritur për të vepruar që prej tetorit të vitit të shkuar dhe sipas kohës që kishte kërkuar opozita, pra opozita pati kohën e plotë në dispozicion, pati çdo gjë në dispozicion për të analizuar sjelljen e institucioneve shtetërore në këtë rast. Parlamenti nuk mund dhe duhet të merret me sjelljen e individëve privatë. Sjellja e individëve privatë sanksionohet gjatë, jo në Kuvendin e Shqipërisë dhe nuk është as në nderin, as në detyrën dhe as në funksionin e këtij Kuvendi. Përderisa detyra jonë duhet të konkludojë me bërjen e propozimeve, të cilat sistemojnë, korrigjojnë kuadrin ligjor dhe me këtë rast akomodojnë, ashtu siç duhet dhe konform ligjit sjelljen e organeve shtetërore, është e qartë se ky duhet të ishte produkt i raportit përfundimtar dhe ky duhet të jetë, për sa na takon, produkt i raportit përfundimtar të këtij komisioni.

Nga ana tjetër, unë do të vlerësoj edhe një herë që fakti se Kuvendi i Shqipërisë ka mundësuar që mbledhjet e komisioneve parlamentare, duke përfshirë edhe komisionin hetimor, të jenë *live* dhe në kohë reale, është një mundësi absolute dhe e papërsëritshme që publiku të vlerësojë, publiku të dëgjojë dhe të ndajë të vërtetën nga gënjeshtria. Besoj se orët e gjata të qëndrimit në këtë komision, orët e gjata të durimit deri në fund të orëve të gjata të pyetjeve, sigurisht, ia kanë dhënë këtë mundësi publikut tanimë që të ndajë të vërtetën nga gënjeshtria dhe shpeshherë, në fakt, e vërteta këtu u shpall edhe përmes kontradiktave të njëpasnjëshme gjatë fjalës goftë të kryetares së këtij komisioni hetimor apo anëtarëve të opozitës.

E thashë edhe një herë, e nisën me histori fantazmash dhe pastaj filluan të flisnin për impiante që i kishin parë dhe filluan të përshkruanin se çfarë kishin parë në ato impiante. Nisi me historinë e 430 milionëshit, si puna e atij gjelit, që u bë gjysmagjeli dhe në fund shkoi te 100 milionëshi. Nuk është momenti për t' i rimarrë edhe një herë detajet, sepse thashë të jeni të sigurt që ato do t' i keni në raport. Raporti përfundimtar është raporti që miratohet me shumicën e votave të këtij komisioni, një raport, i cili do t' i vihet në dispozicion qoftë Kuvendit të Shqipërisë, që do të vendosë për fatin e mëtejshëm të raportit apo të raporteve, qoftë publikut.

E mbyll këtu, duke i ftuar anëtarët e komisionit që të zbatojmë nenin 19 të ligjit për komisionet hetimore, të deklarojmë mbylljen e hetimeve me vendim të ndërmjetëm dhe, njëkohësisht, të biem dakord që data 7 mars të jetë data kur do të paraqesim raportet.

Jorida Tabaku – Faleminderit, zonja Felaj, zonja zëvendëskryetare!

Unë bëj edhe një herë thirrje për personat, të cilët kanë dështuar të sjellin informacionin në këtë komision: zoti Gledis Nano, drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, zonja Brunilda Lilo, avokate e Përgjithshme e Avokaturës së Shtetit, zoti Erion Veliaj, kryetar i Bashkisë së Tiranës, banka e nivelit të dytë, *Credins Bank*, (Ministria e Drejtësisë e ka sjellë përgjigjen, zoti Petrit Vasili,) si dhe zoti Ëngjëll Agaçi, sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrit, që deklaroi se do të na sillte tri procesverbale shumë të rëndësishme dhe relacionin shumë të rëndësishëm të vendimit të nr. 907 të Këshillit të Ministrave, i cili, fatkeqësisht, është fshehur dhe nuk gjendet askund.

Të nderuar qytetarë, për ta përfunduar dhe për të mos e zgajtur shumë, ashtu siç zonja Felaj deklaroi, këto të dhëna mungojnë, por, pavarësisht kësaj, ne do t' i përfundojmë hetimet, sepse nuk kemi më shumë kohë. Data 7 mars do të jetë data e raportit përfundimtar të këtij komisioni. Besoj se të gjithë sot e kanë të qartë, çdo shqiptar e ka të qartë se çfarë ka ndodhur me vjedhjen e 430 milionë eurove. Gënjeshtria i ka këmbët e shkurta, por, edhe kur ata që gënjejnë janë dy metra, përsëri gënjeshtria nuk arrin dot të mbulohet. Unë besoj se vula e turpit për këto 430 milionë euro do t' i mbetet gjatë shtetit shqiptar. Ndiej keqardhje për çdo deputet që nuk ka arritur dot që me integritet, me kurajë dhe me pak motivim personal, ndoshta jo politik, të tregojë, të flasë dhe në fund të ditës ta ndihmojë parlamentin për t' i shërbyer hetimit të kësaj afere.

Ky komision hetimor kishte një objektiv dhe një qëllim: procedurat e dhënies së tri impianteve. Asgjë nuk e justifikon shkeljen e ligjit; asgjë nuk e justifikon vjedhjen; asgjë nuk justifikon korrupsionin.

I konsideroj të mbyllura punimet e këtij komisioni.

Të gjithë anëtarët e komisionit do të punojnë për 10 ditë për raportin përfundimtar.

Faleminderit!

(Diskutim pa mikrofon.)

Besoj se zoti Shalsi është dakord? Kush është dakord për vendimin për përfundimin e hetimeve?

Faleminderit!

E deklaroj të mbyllur këtë hetim.

MBYLLET MBLEDHJA